REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

MINISTRI

Nr.1874/1 prot. **Tiranë, më 04.03.2025**

U R DH Ë R

Nr.213, datë 04.03.2025

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 411, DATË 20.9.2022 "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KONTIGJENCËS PËR SËMUNDJEN E GRIPIT TË SHPENDËVE (INFLUENCA AVIARE)"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 24, të Ligjit Nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U R DH Ë R O J:

Në Urdhrin Nr. 411, datë 20.9.2022 *"Për miratimin e Planit të Kontigjencës për Sëmundjen e Gripit të Shpendëve (Influencës Aviare)"*, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 9.4.1, nënparagrafi 6 riformulohet si më poshtë vijon:

   "Eliminimi nëpërmjet groposjes dhe në një qendër përpunimi i karkasave, vezëve mbeturinave shtazore, ushqimit, plehut sipas legjislacionit në fuqi. Procesi i asgjësimit të ngarkesave të kafshëve të ngordhura ose të eliminuara në qendrat e përpunimit, ndiqet nga veterineri zyrtar i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".

2. Në pikën 17.2. *"Trajtimi i mbeturinave, plehut, kadavrave, vezëve, puplave dhe transportin"*, riformulohet si më poshtë vijon:

   "Trajtimi i mbeturinave, plehut, vezëve, puplave dhe transporti i tyre kryhet në bazë të Ligjit Nr. 10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe Urdhrit Nr. 406, datë 19.9.2008 "Për miratimin e rregullores "Mbi masat veterinare për kontrollin e Sëmundjes së Influencës Aviare në Republikën e Shqipërisë".

"Asgjësimi/trajtimi i kadavrave kryhet:

1. me groposje;

2. në një qendër përpunimi (rendering) që i asgjëson/trajton kadavrat e kafshëve:

- *me incenerim;*
- *me eliminim në një lendfill të autorizuar pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion;*
- *si lëndë djegëse pas përpunimit;*
- *për prodhimin e fertilizantëve organikë ose përmirësuesve të tokës pas përpunimit nëpërmjet sterilizimit nën presion kur është e mundur dhe bëhet markimi i përhershëm i materialeve përfundimtare".*

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri:
   a. Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit;
   b. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve;
   c. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
   ç. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Anila Denaj